



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 72
Prishtinë, më 30 gusht 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR
MË 30 GUSHT 2012**

Mbledhjen e kryesoi kryetari **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmuan nënkryetarët e Kuvendit: **Xhavit HALITI, Sabri HAMITI dhe Enis KERVAN.**

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare. Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 91 deputetë.

Në vazhdim, kryetari procedoi me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Votimi i tekstit të mocionit të Interpelancës së ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas
kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për
vendosjen e tarifës prej 35 % për importimin e çimentos**

Kryetari i njoftoi deputetët se interpelanca me ministren Mimoza Kusari-Lila lidhur me vendimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vendosjen e tarifës prej 35% për importimin e çimentos është mbajtur në mbledhjen plenare të datës 12 e 13 korrik 2012. Debati për këtë pikë ka përfunduar. Por, në mungesë të kuorumit, nuk ka qenë e mundur të vazhdohet me procedimin me votim të mocionit, të paraqitur nga deputeti Emin Gërbeshi.

Në ndërkohë, ministrja Mimoza Kusari-Lila, më datë 25 korrik 2012, ka marrë vendim për përfundimin e masave të përkohshme mbrojtëse të marra me vendimin nr. 4508 të datës 11.6. 2012 të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Vendimi u është shpërndarë deputetëve.

Në lidhje me këtë çështje diskutuan edhe deputetët: Ismet Beqiri, Emin Gërbeshi dhe Myzejene Selmani, diskutimet e plota të të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari propozoi që Kuvendi, nëpërmjet një votimi formal, ta heqë nga rendi i ditës votimin e tekstit të mocionit të interpelancës së ministres Mimoza Kusari-Lila, me arsyetimin se nuk ka objekt për votim.

Kuvendi, me propozimin e kryetarit, vendosi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Pastaj, kryetari propozoi që pikat 2 dhe 3 e rendit të ditës të radhiten si pika 8 dhe 9.

Kuvendi e miratoi propozimin e kryetarit për riradhitjen e dy pikave të cekur më lart.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim,
5. Shqyrtimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012,
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011,
7. Shqyrtimi i Raportit vjetor dhe pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011,
8. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
9. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
10. Debat parlamentar lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, sipas kërkesës së deputetëve nënshkrues.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.

Ministri **Dardan Gashi** tha se me këtë Projektligj rregullohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e pronarëve të njësive të ndërtesës në lidhje me shfrytëzimin, administrimin dhe

mirëmbajtjen e pjesëve, hapësirave dhe pajisjeve të përbashkëta të ndërtesës - bashkëpronësinë në ndërtesë.

Në vazhdim tha se fushëveprimi i këtij Projektligji ka të bëjë me të gjitha ndërtesat për banim, ndërtesat për banim që kanë njësi afariste, që janë në pronësi të më shumë se një pronari, si dhe për komplekse të njësive individuale të banimit dhe afariste, të cilat e kanë në pronësi të përbashkët një territor, në funksion dhe në përdorim ekskluzivisht të pronarëve të njësive.

Më pas ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nijazi Idrizi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Afërdita Berisha-Shaqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Daut Haradinaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 74,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si Komision Funksional dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional Raportues për Projektligjin për pasurimin e miellit.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 72,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për pasurimin e miellit.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e paraqiti deputet Fatmir Xhelili.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1A dhe 2.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-99 për letërnjoftim.

5. Shqyrtimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrime evropiane për vitin 2012

Në emër të Komisionit për Integrime Evropiane, deputeti **Lutfi Haziri** tha se ky Komision, në koordinim me komisionet tjera parlamentare, e ka hartuar dhe Kuvendit ia ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Raportin e dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrime evropiane për vitin 2012.

Në vazhdim ai u fokusua në aspekte të veçanta të këtij raporti, ndërsa në fund i ftoi deputetët për miratimin e këtij raporti.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrime evropiane për vitin 2012.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së - Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” - Alma Lama, në emër të Koalicionit Kosova e Re - Suzan Novobërdali, në emër të Grupit Parlamentar SLS - Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar “6+” - Duda Balje, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	60,
Kundër -----	0,
Abstenime -----	0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti i dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision e kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai, në fund, e përkrahu Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Sala Berisha-Shala - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hashim Dëshishku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----	41,
Kundër -----	3,
Abstenime -----	9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor dhe pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011

Deputeti Ali Sadriu, në emër të Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike tha se si komision e kemi shqyrtuar Raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai, në fund, e përkrahu Raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Valbona Dibra - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Nijazi Idrizi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor dhe pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 54,
Kundër ----- 6,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011.

8. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media

Kryetari i propozoi Kuvendit që pika 8 dhe pika 9 e rendit të ditës: **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media dhe shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës të shqyrtohen si të përbashkëta, për shkak të racionalizimit të kohës.**

Kuvendi e miratoi propozimin e kryetarit.

Në vazhdim, kryetari i informoi deputetët se Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Kandidatët e propozuar nga Komisioni ad hoc për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media i plotësojnë kushtet për t'u proceduar me votim.

Për kandidatin nga komuniteti serb duhet të përsëritet konkursi.

Gjithashtu, edhe Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Kryetari i njoftoi deputetët se duhet të formohet Komisioni Votues, nga një deputet prej secilit grup parlamentar, të cilin e mbështet stafi i Administratës së Kuvendit.

Grupet parlamentare i propozuan anëtarët e Komisionit Votues, si në vijim:

1. G/P PDK - Fadil Demaku,
2. G/P LDK - Armend Zemaj,
3. G/P “Vetëvendosje” - Albulena Haxhiu,
4. G/P AAK - Burim Ramadani,
5. G/P - Koalicioni Kosova e Re - Sevdije Lama,
6. G/P - SLS - Biban Todoroviq,
7. G/P – “6+” - Duda Balje.

Kuvendi e miratoi propozimin e grupeve parlamentare për formimin e Komisionit Votues.

Në vazhdim, kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar për anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media dhe për anëtarët e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Komisioni Votues, me propozimin e kryetarit, procedoi me mënyrën e votimit të fshehtë.

Pas përfundimit të votimit në rundit të parë dhe numërimit të fletëvotimeve, Raportin e Komisionit Votues e paraqiti deputeti Armend Zemaj.

Deputeti Armend Zemaj deklaroi se në votim kanë marrë pjesë 106 deputetë. Sipas numrit të votave që kanë fituar kandidatët e propozuar, rezultati është, si në vijim:

I. Për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media emërohen:

1. Xhemajl Krasniqi, me 64 vota
2. Shefki Ukaj, me 58 vota dhe
3. Drita Begolli, me 61 vota.

II. Për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës emërohen:

1. Ismet Bexheti, me 89 vota dhe
2. Fadil Bajraktari, me 71 vota.

Për kandidatët që kanë fituar më së shumti vota, por jo numrin e mjaftueshëm për t’u zgjedhur, përsëritet rundi i dytë i votimit.

Kryetari i ftoi deputetët një nga një për të votuar.

Pas përfundimit të procedurës së votimit dhe numërimit të fletëvotimeve të rundin e dytë nga Komisioni Votues, deputeti Armend Zemaj e deklaroi rezultatin e votimit, si në vijim:
Në votim kanë marr pjesë 78 deputetë.

I. Për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media emërohen:

1. Emrush Kastrati, me 42 vota dhe
2. Nevzat Hydaverdi, me 51 vota.

II. Për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës emërohen:

1. Majlinda Hajrullahu, me 43 vota,
2. Rahman Paçarizi, me 42 vota dhe
3. Ivan Velković, me 53 vota.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e sotme në orën 19:25 minuta.

E premte, më 31 gusht 2012, ora 15:00

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Kryetari procedoi me pikën e 10-të të rendit të ditës.

10. Debat parlamentar lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, sipas kërkesës së deputetëve nënshkrues

Kryetari në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës e ftoi deputetin Agim Kuleta për prezantimin dhe arsyetimin e kërkesës për debat parlamentar.

Deputeti **Agim Kuleta**, në emër të propozuesit të debatit, tha se që nga përfundimi i luftës, Kosova vazhdon të shfrytëzojë kode të huaja telefonike. Në fillim ishte vazhdimi kodit të Serbisë, e më pastaj kjo u zgjerua edhe me kodin telefonik të Monakos dhe atë të Sllovenisë. Gjendja e tillë vazhdon të jetë edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Pra, me gjithë pavarësinë praktike nga Serbia, të arritur pas luftës çlirimtare, të përkrahur nga forcat e NATO-s, dhe pavarësisë politike e juridike të filluar me shpalljen e pavarësisë, Kosova vazhdon të jetë e varur në fushën e telekomunikacionit, për të cilën po diskutojmë sot.

Ai në vazhdim i sqaroi mënyrat e anëtarësimit të një shteti në Unionin Ndërkombëtar për Telekomunikacion, e cila është agjenci e OKB-së, duke theksuar se ose duhet të jesh anëtar i OKB-së, ose në rastin tjetër kur kërkesën për anëtarësim në Unionin Ndërkombëtar për Telekomunikacion e përkrahin 2/3 e shteteve anëtare të tij.

Këto dy rrugë të anëtarësimit të shtetit të Kosovës në Unionin Ndërkombëtar për Telekomunikacion, e që do të ishte marrje në mënyrë automatike e kodit telefonik të mëvetësishëm, tani për tani janë të pamundura, konstatoi deputeti Agim Kuleta.

Ai më tej tha se shfrytëzimi i kodit të Republikës së Shqipërisë do t'i eliminonte shumë dukuri negative, të cilat kanë të bëjnë me: llojet e humbjeve ekonomike, pagesat për shfrytëzimin e tri kodeve, pagesat për thirrjet e realizuara, lartësia e çmimeve të shërbimeve që diktojnë reduktim të numrit të thirrjeve, e deri te mohimi i mundësisë për ekonomizim më të mirë të këtij biznesi.

Një fenomen tjetër që reflekton në papërshtatshmërinë e përdorimit të këtyre kodeve është edhe lëvizja e madhe e qytetarëve të Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë dhe anasjelltas (qoftë për turizëm apo biznes), gjë që ka bërë që intensiteti i komunikimit ndërmjet tyre nëpërmjet rrjetit telefonik të rritet, ndërkohë që kostoja e këtij komunikimi, për shkak të kodeve të ndryshme, është shumë e lartë.

Më pas, ai i përmendi edhe dëmet në aspektin politik të Kosovës me rastin e përdorimit të kodit telefonik të Serbisë, kur dihet se çfarë krimesh ka bërë Serbia në Kosovë, obstrukcionet e vazhdueshme që i bën ndaj Kosovës nëpërmjet bllokadave të ndryshme, si brenda, ashtu edhe në raportet ndërkombëtare.

Në fund të fjalës së tij, deputeti Agim Kuleta e paraqiti para Kuvendit tekstin e Projektrezolutës së përbërë nga tri pika dhe i ftoi deputetët ta miratojnë atë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan këta deputetë: Zenun Pajaziti - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjosa Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Shaip Muja, Glauk Konjufca, Hydajet Hyseni, Emin Gërbeshi dhe Albin Kurti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi Xhavit Haliti në vazhdim konstatoi se në sallë janë të pranishëm 51 deputetë. Ai konstatoi se në mungesë të kuorumit nuk mund të vazhdohet me procedimin me votim të tekstit të Projektrezolutës. Andaj, kjo pikë do të procedohet për votim në mbledhjen plenare të radhës.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 16:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale